



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 962/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit avokat L.V., me adresë në rr. “Bardhyl Qaushi” Kompleksi KAWA, Hyrja D, nr.1, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga avokate M.B. me zyre në Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 298/23 të datës 15.05.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Baloku me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 10.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Fushë Kosovës ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 294/23 i datës 15.05.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Baloku, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit avokat L.V., ka lëshuar Urdhrit përmbartimor P.nr. 294/23 i datës 15.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Marrëveshje e Ndërmjetësimit nr. 12/2022 e datës 27.12.2022, duke detyruar debitorin Komuna e Fushë Kosovës që në emër të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 312.00 EUR (me shkronja: treqind e dymbëdhjetë) me kamatë vonesë 8% e nga dita e lejimit të këtij propozimi deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përmbartimore në vlerë prej 117.00 euro si dhe të gjitha shpenzimet tjera që do të krijohen në këtë procedurë.

Debitori ka paraqitur prapësim duke kontestuar urdhrin e lejuar për përmbartim me arsyetimin se në këtë rast kemi të bëjmë me një vazhdim të procedurave dhe obligimeve që ka marrë kreditori

nga kontraktuesit e shërbimeve, e që ende pa i përfunduar mirë punën kërkon shpërblimin e pjesshëm. Tutje ka shtuar se marrëveshja e bashkangjitur është e pavërtetuar, e pavulosur të organi kompetent dhe si e tillë nuk paraqet dokument përmbartimor. Andaj, nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 294/23 i datës 15.05.2023 të anulohet.

Kreditori në përgjigje ndaj prapësimi i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit duke shtuar se ky i fundit nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme për pretendimet e tij, dhe se qëllimi i vetëm është zvarritja e procedurës. Ka shtuar se Marrëveshja mbi Ndërmjetësimin paraqet titull ekzekutiv pasi që është lëshuar nga ndërmjetësuesi i licencuar, ndërsa debitori, nuk ka përmbushur detyrimet nga kjo marrëveshje në afat prej 15 ditësh nga nënshkrimi i saj. Ka shtuar se marrëveshja në fjalë përmban vërtetimin mbi ekzekutueshmërinë, andaj është e përshtatshme për përmbartim. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar ndërsa Urdhri Përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së, *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Ndërsa, me nenin 22, pika 1.4 të LPP-së, si një nga dokumentet përmbartuese përcaktohet *“marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimi ne pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin”*.

Gjykata në rastin konkret ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor Marrëveshje e ndërmjetësimi nr. 012/2022 të datës 27.12.2022 mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi, dhe gjeti se palë kontraktuese, përkatësisht kreditor në këtë marrëveshje paraqiten F.B., I.K., Sh.K, N.F. dhe S.K. të përfaqësuar nga avokat L.V., si dhe Komuna e Fushë Kosovës në anën tjetër në cilësi të debitorit.

Në këtë drejtim, Gjykata gjen se kreditori i listuar në propozimin për përmbarrim avokat L.V., nuk është palë në marrëveshjen e ndërmjetësimit por se i njëjti ka vepruar në cilësi të të autorizuarit të palëve, prandaj i njëjti nuk është i autorizuar që të kërkoj realizimin e detyrimit monetar prej 312.00 EUR, pasi që kjo kërkesë monetare i është njohur palëve pjesëmarrëse në procedurën e ndërmjetësimit si shpenzim për përpilimin e padisë nga ana e përfaqësuesit të autorizuar. Si rrjedhojë, avokat L.V. ka mundur të kërkoj realizimin e kërkesave monetare që derivojnë nga kjo marrëveshje vetëm në emër dhe për llogari të palëve kreditore në marrëveshjen e ndërmjetësimit, por jo në cilësinë e tij personale.

Nisur nga një gjendje e tillë, gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, paragrafi 1, pika 1.6, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se “*prapësimi mund të bazohen vetëm nëse*”, ndër të tjera, “*kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarrimin në bazë të dokumentit përmbarrues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarrimin kundër debitorit*” andaj edhe urdhri përmbarrimor të anulohet sepse përkundër faktit që kreditori L.V. figuron si kreditor në propozimin për përmbarrim, i njëjti nuk e ka cilësinë e kreditorit në dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 962/23 datë 10.01.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.